

**Thirrje për ripërtëritjen e angazhimit:
Zotimet e Helsinkit për
parlamente të ndjeshme ndaj gjinisë në rajonin e OSBE-së**

Ne, anëtarët e parlamenteve nga i gjithë rajoni i OSBE-së, të mbledhur në Helsinki, Finlandë, më 3–4 qershor 2025, në seminarin: “Zbatimi i barazisë gjinore në parlament dhe nga parlamenti”, kushtuar rishikimit të përparimit drejt parlamenteve të ndjeshme ndaj gjinisë, çmojmë dhe ripohojmë sa vijon:

- Parlamentet kombëtare, si institucione themelore të demokracisë, kanë një rol të veçantë për të udhëhequr avancimin dhe arritjen e plotë të barazisë gjinore në politikë, si dhe në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Ky rol thelbësor i parlamenteve është sanksionuar qartë në marrëveshjet dhe angazhimet ndërkombëtare, përfshirë Platformën e Pekinit për Veprim të vitit 1995 — 30-vjetori i së cilës përkujtohet këtë vit — dhe Planin e Veprimit të OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore (Vendimi nr. 14/04) të vitit 2004, parimet e të cilit vazhdojnë të udhëheqin përpjekjet tona edhe sot.
- Koncepti i parlamenteve të ndjeshme ndaj gjinisë është shndërruar në shprehjen më të plotë të përgjegjësisë së parlamenteve për të promovuar dhe mbrojtur barazinë gjinore. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërparlamentare kanë luajtur një rol udhëheqës në këtë drejtim nëpërmjet gjenerimit të bazës së të dhënave dhe programeve politike që nxisin veprimet e mëtejshme. Deklarata e Kigalit e Unionit Ndërparlamentar të vitit 2022 mbetet një dëshmi e fuqishme e angazhimit global parlamentar ndaj kësaj agjende.
- Shumë organizma ndërqeveritare tashmë po akordojnë burime për eliminimin e pengesave për pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave në parlament dhe fuqizimin e parlamenteve për të arritur barazinë gjinore, politikën për barazi gjinore, si dhe mbikëqyrjen parlamentare me ndjeshmëri gjinore.

Gjatë tre dekadave të fundit, kemi qenë dëshmitarë të përparimeve të paprecedenta në avancimin e barazisë gjinore brenda parlamenteve. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë:

- Trefishuar mesataren e përfaqësimit të grave në parlamente, që aktualisht arrin në 31.6%;
- Miratuar ligje novatore për barazinë gjinore, të cilat synojnë të luftojnë diskriminimin me bazë gjinore dhe të promovojnë integrimin gjinor në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes;
- Forcuar ministritë, agjencitë dhe këshillat përgjegjëse për politikën e barazisë gjinore dhe realizimin e të drejtave të grave;
- Zbatuar masa të veçanta për periudha të përkohshme — përfshirë kuotat gjinore të vendosura në ligj dhe financimin e partive sipas kriterëve gjinore — për të ulur mbipërfaqësimin e burrave dhe për të ndërtuar një politikë të balancuar gjinore në afat të gjatë.

Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, progresi është ngadalësuar në të gjithë rajonin e OSBE-së. Jemi dëshmitarë të shenjave shqetësuese të regresit në fushën e barazisë gjinore, si dhe

të një rezistence dhe mobilizimi në rritje kundër saj. Tani, më shumë se kurrë, zhvillimi i parlamenteve me ndjeshmëri gjinore është thelbësor për të përballuar këto prirje negative.

Në këtë kontekst, ne, Anëtarët e Parlamenteve nga rajoni i OSBE-së, bëjmë thirrje për ripërtëritjen e angazhimit ndaj agjendës globale për parlamente me ndjeshmëri gjinore dhe ndaj parimit të barazisë gjinore si një normë e përhershme dhe parim i qeverisjes.

Ne u bëjmë thirrje të posaçme parlamenteve të vendeve në të gjithë rajonin e OSBE-së që të:

1. Marrin angazhimin politik kombëtar për të arritur barazinë gjinore brenda dhjetëvjeçarit të ardhshëm, të mbështetur nga një plan veprimi i matshëm dhe realist, si dhe objektiva përfaqësimi që shtrihen përgjatë tre cikleve të ardhshme zgjedhore.
2. Zhvillojnë auditime gjinore me pjesëmarrje të gjerë në çdo legjislaturë, për të vlerësuar në ç'masë është respektuar barazia gjinore në funksionet kryesore të parlamentit — përfaqësim, legjislacion dhe mbikëqyrje parlamentare.
3. Krijojnë një grup drejtues me përfaqësim të balancuar gjinor, për të ndjekur rekomandimet e auditimeve gjinore, për të udhëhequr zbatimin e masave konkrete dhe transformuese si pjesë e planeve të veprimit për barazi gjinore në parlament, dhe për të mbikëqyrur procesin e transformimit institucional.
4. Nxisin reforma legjislative që rrisin pjesëmarrjen politike të grave, jo vetëm në parlament, por edhe në partitë politike dhe organet përfaqësuese dhe ekzekutive në nivel kombëtar dhe vendor.
5. Rishikojnë dhe përditësojnë rregullisht Rregulloren e Parlamentit dhe kornizat e tjera rregullatore, për të promovuar përfaqësimin e balancuar gjinor në të gjitha strukturat parlamentare dhe për të rritur ndjeshmërinë gjinore në proceset legjislative dhe të mbikëqyrjes.
6. Forcojnë mandatin, burimet, mjetet dhe kapacitetet e komisioneve parlamentare dhe strukturave të tjera përkatëse, për të siguruar që nevojat dhe perspektivat e të gjitha gjinive të pasqyrohen në procesin e ligjbërjes dhe mbikëqyrjes, duke u bazuar në përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë.
7. Zhvillojnë programe të synuara për të angazhuar më shumë burra politikanë — përfshirë deputetët meshkuj — si aleatë dhe aktorë transformues, që të ndajnë përgjegjësinë me gratë lidere në avancimin e politikave për barazi gjinore dhe arritjen e barazisë së plotë.
8. Konsiderojnë dhunën ndaj grave në politikë si një pengesë serioze për pjesëmarrjen e tyre, dhe ta parandalojnë e luftojnë atë nëpërmjet politikave gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara, sanksioneve, kërkit shënkencor, trajnimeve, ndërgjegjësimi dhe mekanizmave të raportimit.
9. Konsiderojnë parlamentin si një vend pune, duke promovuar një kulturë që mbështet balancimin mes jetës private dhe punës, pa harruar detyrimet e deputetëve dhe stafit parlamentar për kujdes ndaj familjes.
10. Sigurojnë që buxhetet kombëtare të hartohen dhe zbatohen në përputhje me prioritetet e politikave për barazi gjinore, duke u bazuar në praktikën ndërkombëtare të buxhetimit të ndjeshëm ndaj gjinisë.
11. Identifikojnë dhe eliminojnë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen politike të grupeve të nënpërfaqësuar — përfshirë të rinjtë, banorët e zonave rurale, personat me aftësi të kufizuara dhe anëtarët e pakicave kombëtare apo etnike — me një fokus të veçantë tek

gratë e këtyre grupeve, përmes nismave që fuqizojnë përfaqësimin gjithëpërfshirës dhe promovojnë diversitetin në parlament.

12. Marrin masa proaktive për të identifikuar dhe kundërshtuar prirjet regresive kombëtare dhe globale kundër barazisë gjinore, përmes monitorimit të vazhdueshëm, komunikimit të qëllimshëm, përkrahjes dhe veprimit të koordinuar politik, duke sfiduar normat dhe stereotipat që pengojnë barazinë e vërtetë.

Së bashku, siç përcaktohet në këto zotime, duhet të ndërtojmë parlamente që shprehin barazinë, diversitetin dhe mbrojnë të drejtat e çdo qytetari — duke synuar barazinë 50:50 mes grave dhe burrave, dhe duke siguruar që të gjithë zërat, pa dallim brezi apo prejardhjeje, të dëgjohen dhe përfaqësohen.